



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 51 (827956)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 26 dhjetor 2025



SHQIPËRIA PAJISËT ME SISTEMIN RAKETOR KUNDËRTANK "JAVELIN", HAP I RËNDËSISHËM NË MODERNIZIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA

» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI, TAKIM ME KOMANDANTIN E FSK-SË GJATË VIZITËS NË KOSOVË

Gjatë një vizite zyrtare në Kosovë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet aktuale në fushën e sigurisë, si dhe mbi progresin...



faqe 6



KUR UNIFORMA BASHKOHET ME SHPIRTIN E FESTËS

Nga tryeza festive të detyra kombëtare: Roli i gruas shqiptare. Festat e fundvitit përbëjnë një nga momentet më të rëndësishme në jetën shoqërore dhe familjare të shqiptarëve. Ato nuk janë thjesht ditë pushimi apo rituale të përsëritura, por ngërthejnë vlera të thella kulturore, shpirtërore dhe njerëzore. Në thelb të këtyre festave qëndron familja, dhe në qendër të familjes gruaja shqiptare...



faqe 9



NGA MALLAKASTRA E VITIT 1943 TE FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE NË MISIONE PAQEJE

Ka momente në historinë e një kombi që nuk maten me data, por me peshën morale që mbartin. Janë momente kur një shoqëri vihet përballë zgjedhjes më të vështirë: të mbijetojë duke heshtur, apo të rrezikojë duke mbrojtur jetën e tjetrit. Shqipëria e ka kaluar këtë provë shumë herë, por një nga shembujt...



faqe 8

Gjenerallejtënant Arben Kingji, takim me Komandantin e FSK-së gjatë vizitës në Kosovë

Gjatë një vizite zyrtare në Kosovë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim me Komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari.

Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet aktuale në fushën e sigurisë, si dhe mbi progresin e bashkëpunimit dypalësh ushtarak ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Palët vlerësuan nivelin e bashkëpunimit ekzistues dhe mundësitë për thellimin e mëtejshëm të tij përmes aktiviteteve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Gjenerallejtënant Arben Kingji shprehu vlerësimin e tij për gjenerallejtënant Bashkim Jasharin, duke theksuar lidhshypin dhe gatishmërinë e treguar në rritjen e bashkëpunimit dhe intensifikimin e aktiviteteve të përbashkëta ushtarake mes dy institucioneve.



Në këtë kuadër, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm riafirmoi mbështetjen dhe përkushtimin e palëkundur të Forcave të Armatosura Shqiptare për forcimin e kapaciteteve operacionale, ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit, si dhe për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi të përbashkëta në rajon. Takimi u zhvillua në frymën e partneritetit dhe bashkëpunimit të ngushtë, duke konfirmuar vullnetin e përbashkët për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ushtarake mes Shqipërisë dhe Kosovës.



Ceremoni solemne në Portin e Izmirit për 100-vjetorin e Forcës Detare

Në Portin e Izmirit u zhvillua ceremonia solemne me rastin e 100-vjetorit të Forcës Detare, e organizuar në bordin e anijes "Lissus" P-133, pjesë e misionit të përbashkët në Detin Egje.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të Rojës Bregdetare Turke, autoritete portuale, policore, doganore, si edhe përfaqësues të institucioneve civile. Të ftuarit u pritën nga komandanti i Kontingjentit, kapiten i rangut III Eldi Ormeni.

Ceremonia u hap me intonimin e Himnit Kombëtar, pasuar nga fjala përshëndetëse e Komandantit të kontingjentit, i cili vlerësoi bashkëpunimin dhe kontributin e personelit në kuadër të misionit të përbashkët detar, si dhe rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë detare.

Në vijim, u zhvillua ceremonia e dhënies së certifikatave të mirënjohjes për personelin e



angazhuar në operacionet e përbashkëta në Detin Egje, si shenjë vlerësimi për profesionalizmin, përkushtimin dhe kontributin e tyre në përmbushjen e detyrave operacionale.

Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë solemne



dhe miqësore, duke reflektuar nivelin e lartë të bashkëpunimit mes forcave detare dhe strukturave partnere, si dhe duke shënuar një moment të rëndësishëm për Forcën Detare në kuadër të 100-vjetorit të saj.

Shqipëria pajiset me sistemin raketor kundërtank “Javelin”, hap i rëndësishëm në modernizimin e Forcave të Armatosura

Shqipëria është pajisur zyrtarisht me sistemin raketor kundërtank “Javelin”, një nga sistemet më të avancuara të mbrojtjes tokësore, i përdorur gjerësisht nga vendet anëtare të NATO-s. Lajmi u bë i ditur nga ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i cili theksoi se ardhja e këtij sistemi është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sipas ministrit Vengu, pajisja e Forcave të Armatosura Shqiptare me sistemin “Javelin” përfaqëson një hap të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe në përmbushjen e objektivave të modernizimit të ushtrisë, në përputhje me standardet e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

“Ardhja e sistemeve ‘Javelin’, falë bashkëpunimit me aleatin tonë strategjik SHBA, forcon aftësitë mbrojtëse të Forcave të Armatosura Shqiptare, rrit parandalimin, ndërveprueshmërinë me NATO-n dhe sigurinë kombëtare”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Sistemi “Javelin” konsiderohet një element kyç për mbrojtjen tokësore, duke rritur ndjeshëm aftësinë e Forcës Tokësore për të përballuar kërcënime të avancuara, veçanërisht ndaj mjeteve të blinduara, si dhe për të vepruar në mënyrë efektive në mjedise komplekse operacionale.

“Javelin” është një sistem raketor kundërtank i gjeneratës së fundit, i prodhuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i njohur për saktësinë e lartë dhe efektivitetin e tij në operacione reale luftarake. Ky sistem përdoret nga ushtritë e vendeve të NATO-s dhe partnerëve strategjikë, duke përfaqësuar një standard të lartë në fushën e mbrojtjes tokësore. Shqipëria e ka porositur sistemin “Javelin” në kuadër të programeve të bashkëpunimit ushtarak me Shtetet e Bashkuara, përmes mekanizmit të shitjeve ushtarake të huaja (Foreign Military Sales - FMS). Ky investim është pjesë e strategjisë afatgjatë për modernizimin e Forcave të Armatosura, rritjen e kapaciteteve parandaluese dhe përafrimin e plotë me doktrinën dhe kapacitetet e NATO-s, duke forcuar më tej sigurinë kombëtare dhe rajonale.



Akademia e Forcave të Armatosura, fituese e Maratonës Kombëtare të Sigurisë Kibernetike

Ekipi i Akademisë së Forcave të Armatosura u shpall fitues i Maratonës Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, një aktivitet i organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, ku morën pjesë ekipe nga institucione akademike dhe struktura të ndryshme publike e private.

Ky sukses dëshmon nivelin e lartë të përgatitjes profesionale dhe akademike të studentëve dhe pedagogëve të Akademisë së Forcave të Armatosura, si dhe përkushtimin e vazhdueshëm për ndërtimin e kapaciteteve bashkëkohore në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Arsimi dhe inovacioni mbeten dy nga prioritetet kryesore strategjike, të cilat ndërthuren natyrshëm në fushën e sigurisë kibernetike. Fitorja në këtë maratonë konfirmon se investimet dhe puna sistematike për forcimin e këtyre kapaciteteve po japin rezultate konkrete.

Autoritetet theksuan se angazhimi dhe investimet në sigurinë kibernetike do të vijojnë edhe në vitin 2026,



me buxhetin më të madh ndonjëherë për mbrojtjen, duke vendosur sigurinë kibernetike dhe arsimin në qendër të vëmendjes strategjike të Forcave të Armatosura dhe institucioneve përgjegjëse. Ky aktivitet shërbeu gjithashtu si një platformë e rëndësishme bashkëpunimi dhe shkëmbimi përvojash, duke nxitur talentin e ri dhe inovacionin në përballjen me sfidat gjithnjë e më komplekse të hapësirës kibernetike.



Rikonstruksioni i ish-repartit ushtarak në Mollëz, bazë e re për Batalionin III të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë inspektuese në ambientet e ish-repartit ushtarak në Mollëz, ku parashikohet ngritja e qendrës së re operacionale të Batalionit III të Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut.

Ky repart, i cili në të kaluarën ka shërbyer si garnizon dhe depo ushtarake, ka pasur gjithashtu një rol të rëndësishëm gjatë luftës në Kosovë, duke u përdorur për stërvitjen e forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas viteve të degradimit dhe braktisjes, objekti do t'i nënshtrohet një rikonstruksioni tërësor, në kuadër të planit afatmesëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Sipas masterplanit tashmë të miratuar, infrastruktura do të përshtatet për të akomoduar një batalion të plotë këmbësorie, duke zgjeruar ndjeshëm kapacitetet e Regjimentit të Veriut. Aktualisht, në Burrel operon një kompani e plotë, ndërsa projekti synon rritjen e forcës aktive me rreth 30%, si dhe krijimin e njësisë të para të forcës rezerviste.

Ministri Vengu theksoi se investimi është konceptuar të jetë i qëndrueshëm, funksional dhe efikas, me fokus përmbushjen e misioneve operacionale të Forcave të Armatosura. Struktura e re do të akomodojë rreth 648 efektivë, prej të cilëve 401 personel aktiv dhe 247 rezervistë, të shpërndarë në një sipërfaqe prej rreth 366 hektarësh.

Territori ofron kushte shumë të favorshme për stërvitje, akomodim, aktivitete sportive dhe rekreative, si dhe për ndërtimin e poligoneve dhe terreneve ndihmëse. Zona, e lirë nga banesat civile, garanton standarde të larta sigurie dhe akses të përshtatshëm në



infrastrukturën e energjisë elektrike dhe ujësjellësit. Misioni kryesor i Batalionit të Burrelit do të jetë përgatitja, trajnimi dhe mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve operacionale për mbrojtjen e vendit. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe mbështetjes në emergjencë civile, si pastrimi i rrugëve nga bora, përbalimi i zjarreve dhe situatave

të tjera të jashtëzakonshme, veçanërisht në zonën verilindore të vendit. Projekti parashikon ndarjen e repartit në tre zona funksionale: zonën administrative, zonën logjistike dhe mbrojtëse, si dhe zonën e jetesës dhe stërvitjes, duke krijuar një garnizon modern që përmbush standardet bashkëkohore të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Angazhimi i Shqipërisë në KFOR, në fokus të takimit mes gjenerallejtënant Arben Kingji dhe gjeneralmajor Ulutaş

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, zhvilloi një takim zyrtar me Komandantin e Misionit të KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş, ku u diskutua mbi situatën e sigurisë në Kosovë dhe në rajon.

Gjatë takimit, dy drejtuesit shkëmbyen pikëpamje mbi rolin thelbësor të KFOR-it në ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe sigurisë në Kosovë, si dhe rëndësinë e pranisë së NATO-s për garantimin e një mjedisi të qëndrueshëm të sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Gjenerallejtënant Arben Kingji theksoi se Shqipëria mbetet plotësisht e përkushtuar në përmbushjen e detyrimeve të saj në kuadër të misioneve të NATO-s, duke vijuar kontributin aktiv dhe profesional në KFOR. Ai shprehu gjithashtu mirënjohjen për vlerësimin e dhënë nga gjeneralmajor Özkan Ulutaş ndaj kontributit dhe profesionalizmit të personelit dhe forcave shqiptare të angazhuara në këtë mision.

Nga ana e tij, Komandanti i KFOR-it vlerësoi rolin



dhe angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë mes aleatëve për përbalimin e sfidave të sigurisë dhe ruajtjen e paqes në Kosovë dhe më gjerë në rajon.

Takimi konfirmoi edhe një herë angazhimin e përbashkët për forcimin e bashkëpunimit në kuadër të NATO-s dhe mbështetjen e vazhdueshme për stabilitetin dhe sigurinë rajonale.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Refleksion në prag festash "Kurrë mos e shit shtëpinë e babait"

Ka shtëpi që ndërtohen për t'u banuar dhe ka shtëpi që ndërtohen për të mbajtur mend. Shtëpia e babait i përket kësaj të dytës. Ajo nuk është thjesht një strehë nga shiu e dimri, por një vend ku jeta ka lënë shenja, ashtu siç lë lumi shenja në gur.

Qëndron zakonisht pak mënjane, e heshtur, pa pretendime. Nuk të thërret me zë të lartë, por nëse di të dëgjosh, e ndien se ajo flet. Flet me gjuhën e mureve të vjetër, me erën e drurit, me kërcitjen e dyshemesë në mbrëmje. Flet me një gjuhë që nuk mësohet në shkollë, por në jetë.

Kush është larguar prej saj, e di se largimi nuk është ikje e vërtetë. Është vetëm shtyrje në kohë. Sepse shtëpia e babait nuk harrohet. Ajo nuk të ndjek, nuk të kërkon llogari, por rri aty, si një borxh që nuk të rëndon, por që e di se ekziston. Në atë shtëpi gjithçka ka qenë e thjeshtë dhe, pikërisht për këtë arsye, e vërtetë. Bukë e ngrohtë në sofër, edhe kur ishte pak. Një fjalë e prerë e babait që nuk përsëritej dy herë. Një heshtje e nënës që thoshte më shumë se çdo këshillë. Aty jeta nuk shpjegohej; jetohej.

Kur njeriu emigron, mendon se po largohet nga mungesa. Dhe është e vërtetë. Por, pa e kuptuar, largohet edhe nga një pasuri që nuk e njih ende. Sepse disa gjëra i kupton vetëm kur i humb. Dhe shtëpia e babait fillon të marrë peshë pikërisht atëherë kur nuk je më aty.

Vitet kalojnë. Njeriu mëson gjuhë të reja, zakone të reja, ritme të reja. Ndërton një jetë që funksionon. Por brenda tij mbetet një dhomë e pashtuar, një qoshe që nuk mobilizohet dot me asgjë moderne.

Kurrë mos e shit shtëpinë e babait Arkivi i heshtur i jetës

Ka fjalë që nuk i prodhon mendja, por përvoja. Ka fjali që nuk shkruhen për t'u lexuar shpejt, por për t'u mbajtur mend gjatë.

Nuk është thirrje sentimentale, as romantizëm provincial. Është një deklaratë identiteti, një paralajmërim moral në një kohë kur gjithçka duket e tregtueshme, e konvertueshme në para, e zhveshur nga kuptimi.

Sidomos në prag të festave të fundvitit, kur emigranti ndjen më fort se kurrë se jeta që jeton nuk është domosdoshmërisht jeta që ëndërroi.

Shtëpia e babait nuk është pronë, është dëshmi

Në gjuhën e dokumenteve, shtëpia është një pasuri. Në gjuhën e shpirtit, ajo është një dëshmi. Dëshmi se dikur kemi qenë fëmijë. Se dikur kemi pasur një vend ku ishim të njohur pa u prezantuar.

Shtëpia e babait nuk matet me metra katrorë, por me kujtime. Aty janë gërvishtjet në mure, hapat e padukshëm në korridor, zërat që nuk dëgjohen më, por që nuk janë shuar kurrë.

Kur ajo shtëpi shitet, nuk largohet vetëm një familje nga një adresë. Shkëputet një brez nga rrënja e vet.

Emigrimi, rrugë shpëtimi apo rrugë harrese?

Emigrimi, fenomen botëror. Por me kalimin e viteve, ai u kthye edhe në një proces të ngadaltë harrese.

Në fillim ikja për bukën e gojës. Më pas për dinjitet. Më vonë për ëndrrat e fëmijëve tanë. Dhe, pa e kuptuar, largimi edhe nga vetja.

Sa më shumë integroresh, aq më shumë rrezikon të shkëputesh. Dhe pikërisht këtu shtëpia e babait bëhet spirancë.

Aty ku jeta nuk kishte nevojë të shpjegohej



Fundviti: momenti kur koha nuk mashtrohet

Gjatë vitit, emigranti ia del të mashtrojë veten. Me punë, me ritëm, me angazhime. Por fundviti nuk mashtrohet...

Në dhjetor, kur qytetet ndriçohen, brenda njeriut errësohet. Jo nga trishtimi, por nga krahasimi. Krahasimi mes asaj që ke dhe asaj që mungon.

Në ato ditë, shtëpia e babait shndërrohet në metër të jetës. Aty matet largësia reale nga vetja.

Nostalgjia nuk është dobësi, është kujtesë aktive

Shpesh nostalgjia shihet si dobësi. Në të vërtetë, ajo është kujtesë aktive, rezistencë ndaj shpërbërjes së identitetit. Nostalgjia e emigrantit nuk është për varfërinë, por për kuptimin, për thjeshtësinë, për marrëdhëniet që nuk kishin nevojë për kontrata. Shtëpia e babait është vendi ku nostalgjia nuk është dhimbje, por dialog me të kaluarën.

Dashuritë e para nuk emigrojnë kurrë

Dashuritë më të rëndësishme të jetës nuk kanë pasaportë. Ato mbeten aty ku lindën. Në dhomën e fëmijërisë, në oborr, në shkallët e shtëpisë. Aty ku u mësua për herë të parë çfarë është pritja, çfarë është zhgënjimi, çfarë është shpresa. Kur shet shtëpinë e babait, i lë këto dashuri pa adresë.

Dhimbjet që na mësuat të jemi njerëz

Në atë shtëpi janë dhimbjet tona më të pastra. Dhimbje pa spektatorë, pa rrjete sociale, pa shpjegime. Aty u mësua për herë të parë humbja, u kuptua se jeta nuk është gjithmonë e drejtë. Por edhe se dhimbja ndahet dhe përballohet më lehtë kur nuk je vetëm.

Emigrimi i bëri dhimbjet më të sofistikuara, por edhe më të vetmuara.

Fitoret e heshtura që askush nuk i pa

Sa fitore kemi bërë që nuk u festuan kurrë? Sa arritje që nuk patën duartrokitje?

Shtëpia e babait i di të gjitha, kurrë me zë të lartë. Ajo është arkivi moral i jetës sonë.

Shtëpia si busull kombëtare

Adresa ku ende jemi vetja

Në një shoqëri që lëviz shumë dhe rrënjësohet pak, shtëpia e babait është busull kombëtare. Ajo ruan gjuhën, zakonet, mënyrën e të menduarit.

Shitja e saj nuk është akt individual. Është akt që ndikon në zbrazjen kulturore të vendit.

Brezi i dytë dhe rreziku i shkëputjes totale

Fëmijët e emigrantëve rriten mes dy botëve. Nëse nuk u lëmë një vend konkret ku të kthehen, rrezikojmë t'u lëmë vetëm një identitet të paqartë. Shtëpia e babait është pika ku brezi i dytë kupton se ka histori, jo vetëm të ardhme.

Mos e shit, edhe kur duket barrë

Edhe kur është e vjetër. Edhe kur kërkon investim. Edhe kur duket e panevojshme. Ka gjëra që nuk mbahen për përdorim, por për kuptim.

Një amanet për kohët moderne

Metra kujtese

Në një epokë ku gjithçka matet me vlerë tregu, shtëpia e babait duhet të mbetet jashtë tregut. Sepse ajo është vendi ku njeriu kthehet për t'u kujtuar kush është, jo për të treguar çfarë ka. Kurrë mos e shit shtëpinë e babait. Sepse aty nuk është thjesht e shkuara jote. Aty është e vërteta jote më e pastër.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Trashëgimia e pilotit Riza Lahi, forca e fjalës dhe vizioni i brezit të ri

Në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare ka figura që nuk shuhen kurrë. Jo sepse mbeten vetëm në arkiva apo në fotografi bardhë e zi, por sepse vepra e tyre vazhdon të jetojë në breza. Një nga këto figura është Riza Lahi, pilot i Forcave të Armatosura dhe poet i ndjerë, njeri i qiellit dhe i fjalës, i cili la pas një trashëgimi të dyfishtë: shërbimin ushtarak me përkushtim maksimal dhe artin si formë reflektimi shpirtëror.

Sot, kjo trashëgimi nuk mbetet vetëm kujtim. Ajo mishërohet në figurën e nipit të tij, Arkel Lahi, student i Akademisë së Forcave të Armatosura, i cili me punë, disiplinë dhe vizion bashkëkohor, po ecën me dinjitet në gjurmët e arta të gjyshit.

Riza Lahi, oficeri që fluturoi mbi detyrën dhe poezinë

Riza Lahi ishte nga ata burra që e shihnin uniformën jo si privilegj, por si përgjegjësi të shenjtë. Si pilot i Forcave të Armatosura, ai i përkiste një brezi që e ndërtoi aviacionin shqiptar me sakrificë, disiplinë dhe guxim të jashtëzakonshëm. Fluturimi për të nuk ishte thjesht profesion, ishte mision.

Në çdo ngritje ajrore, Riza Lahi mbante mbi supe jo vetëm peshën e mjetit luftarak, por edhe besimin e shtetit dhe të popullit. Ai ishte shembull i oficerit korrekt, i qetë në vendimmarrje dhe i palëkundur në detyrë. Koleget e kujtojnë si njeri të fjalës së pakët dhe të veprës së madhe.


Por Riza Lahi kishte edhe një dimension tjetër, po aq fisnik: poezinë.

Në orët e qeta pas shërbimit, ai shkruante vargje që flisnin për jetën, atdheun, qiellin dhe njeriun. Poezia e tij ishte reflektim i brendshëm i një oficeri që e kuptonte thellë peshën e kohës dhe të përgjegjësisë. Ai nuk e ndante dot ushtarakun nga poeti, të dy bashkë formonin personalitetin e tij.

Një ndarje fizike, por jo shpirtërore

Ndarja nga jeta e Riza Lahit la një boshllëk të madh në rrethin familjar, shoqëror dhe profesional. Por si çdo figurë e madhe, ai nuk u largua pa lënë pas një rrugë për t'u ndjekur. Ai la vlera, frymëzim dhe një shembull që nuk tretet me kohën.

Në familjen Lahi, emri i tij nuk përmendet vetëm si kujtim, por si standard. Një standard që kërkon përkushtim, ndershmëri dhe shërbim ndaj atdheut.



Arkel Lahi - Brezi që ndërton të ardhmen mbi themele të forta

Në këtë vazhdimësi vlerash shfaqet figura e Arkel Lahit, nipi i Riza Lahit, i cili sot është student i Akademisë së Forcave të Armatosura. Që në hapat e parë të formimit të tij, Arkel ka treguar se zgjedhja për të ndjekur rrugën ushtarake nuk është rastësi, por ndërgjegje. Ai përfaqëson një brez të ri oficerësh në formim të përgatitur akademikisht, të hapur ndaj teknologjisë dhe të ndërgjegjshëm për sfidat moderne të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Suksesi në teknologji, një arritje që flet për vizion

Një nga momentet më domethënëse të rrugëtimit





Akademia e Forcave të Armatosura terren i formimit të elitës

Suksesi i Arkel Lahit është njëkohësisht edhe sukses i Akademisë së Forcave të Armatosura, e cila vijon të mbetet institucioni kyç për formimin e elitës ushtarake shqiptare. Akademia nuk formon vetëm oficerë, por liderë, mendimtarë strategjikë dhe qytetarë me përgjegjësi të lartë kombëtare. Përmes studentëve si Arkel Lahi, Akademia dëshmon se tradita dhe moderniteti mund të bashkëjetojnë me sukses.

Gjurmët e arta që vazhdojnë

Historia e Riza Lahit dhe Arkel Lahit është historia e vazhdimësisë. Është historia e një fluturimi që nuk

përfundon me ndarjen nga jeta, por vazhdon në formën e përpjekjes, dijes dhe shërbimit.

Nëse Riza Lahi fluturoi në qiellin e atdheut dhe në vargjet e poezisë, Arkel Lahi po fluturon sot në qiellin e dijes dhe teknologjisë, duke mbajtur lart emrin e familjes dhe uniformës shqiptare.

Në një shoqëri që ka nevojë për modele reale, figura si Riza Lahi dhe Arkel Lahi janë dëshmi se vlerat nuk humbasin, por transmetohen. Ato kërkojnë përkushtim, punë dhe besim në ideal.

Gazeta “Ushtria” ka privilegjin të sjellë këtë portret si një homazh për të kaluarën dhe një besim të fortë për të ardhmen e Forcave të Armatosura Shqiptare.

të Arkel Lahit është fitimi i vendit të tretë në fushën e teknologjisë, duke përfaqësuar denjësisht Akademinë e Forcave të Armatosura. Ky sukses nuk është thjesht një çmim, por dëshmi e aftësisë së tij për të kombinuar disiplinën ushtarake me inovacionin teknologjik.

Në një kohë kur ushtritë moderne mbështeten gjithnjë e më shumë në teknologji, analiza të avancuara dhe sisteme inteligjente, ky rezultat tregon se brezi i ri i oficerëve shqiptarë është i gatshëm të ecë me kohën. Arkel Lahi dëshmoi se trashëgimia nuk është vetëm e kaluar, por edhe vizion për të ardhmen.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka momente në historinë e një kombi që nuk maten me data, por me peshën morale që mbartin. Janë momente kur një shoqëri vihet përballë zgjedhjes më të vështirë: të mbijetojë duke heshtur, apo të rrezikojë duke mbrojtur jetën e tjetrit. Shqipëria e ka kaluar këtë provë shumë herë, por një nga shembujt më domethënës mbetet ai i dhjetorit 1943, në fshatrat e Mallakastrës, ku humanizmi u kthye në akt rezistence dhe bashkëjetesa fetare në mburojë shpëtimi.

Në atë dimër të ashpër, Lufta e Dytë Botërore kishte shkatërruar jo vetëm qytete dhe fshatra, por edhe kufijtë moralë të njerëzimit. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, mijëra ushtarë italianë mbetën të braktisur në territoret ku kishin shërbyer. Në Shqipëri, ata u kthyen nga pushtues në njerëz të pambrojtur, të ndjekur nga forcat naziste gjermane, për të cilat ndihma ndaj tyre përbënte krim të dënueshëm me vdekje.

Në këtë realitet brutal, Mallakastra një zonë e varfër, rurale dhe e ekspozuar ndaj represionit u shndërrua në një hapësirë të jashtëzakonshme qëndrese morale. Mbi 200 ushtarë italianë u strehuan nga banorët vendas, të cilët, ndonëse kishin pak ushqim, pak siguri dhe shumë frikë, zgjodhën të mos e braktisnin parimin themelor: jeta njerëzore është e shenjtë.

Ky akt nuk ishte i organizuar nga struktura shtetërore dhe as i diktuar nga ideologji politike. Ai lindi nga kultura e thellë shqiptare e besës, e nderit dhe e respektit për tjetrin. Banorët e Mallakastrës e dinin rrezikun, por e pranuan atë si çmim për të mos humbur ndërgjegjen. Ky është thelbi i humanizmit në kohë lufte.

Në këtë histori, bashkëjetesa fetare nuk shfaqet si koncept teorik, por si praktikë jetësore. Myslimanë, bektashinj dhe të krishterë shqiptarë strehuan ushtarë katolikë italianë, pa pyetur për përkatësi fetare, kombëtare apo politike. Feja nuk u bë vijë ndarëse, por burim force morale. Ajo u shndërrua në motiv për të bërë atë që ishte e drejtë, edhe kur ishte e rrezikshme.

Krishtlindja e vitit 1943 u festua në heshtje, në shtëpi të errëta, stane dhe bodrume. Pa kambana, pa ceremoni, por me një copë bukë të ndarë dhe me shpresën se e mira nuk ishte zhdukur. Ishin Krishtlindje pa dritë elektrike, por me dritë njerëzore. Ishin Krishtlindje ku mesazhi i paqes u jetua, jo u shpall.

Për dekada me radhë, kjo histori mbeti në hije, e ruajtur në kujtesën familjare si një amanet i pashkruar. Sot, ajo merr një kuptim të ri, jo vetëm si fakt historik, por si udhërrëfyes strategjik për mënyrën se si Shqipëria e koncepton sigurinë, paqen dhe rolin e saj në botë.

Në një kontekst bashkëkohor, ku konfliktet vazhdojnë të prodhojnë viktima civile, zhvendosje masive dhe kriza humanitare, kjo faqe historie na kujton se paqja nuk është vetëm rezultat i forcës ushtarake, por edhe i vlerave që e udhëheqin atë forcë. Pikërisht këtu lidhet drejtpërdrejt trashëgimia e Mallakastrës me misionin e sotëm të Forcave të Armatosura Shqiptar.

FA-të nuk janë më vetëm një instrument mbrojtjeje territoriale. Sot, ato janë një aktor i rëndësishëm i sigurisë kolektive, i angazhuar në misione paqeruajtëse dhe humanitare nën ombrellën e NATO-s, OKB-së dhe BE-së. Në këto misione, ushtarakët shqiptarë përfaqësojnë jo vetëm një shtet, por edhe një kulturë: kulturën e respektit për jetën, për dinjitetin njerëzor dhe për bashkëjetesën.



Kur humanizmi u bë fe dhe feja u bë mision Nga Mallakastra e vitit 1943 te Forcat e Armatosura Shqiptare në misione paqeje

Nga Bosnja në Kosovë, nga Afganistani në Irak e deri në misionet aktuale, efektivet shqiptarë kanë dëshmuar profesionalizëm, disiplinë dhe ndjeshmëri humane. Ata kanë vepruar në mjedise multikulturore dhe multifetare, duke ndërtuar besim me komunitetet lokale, pikërisht sepse vijnë nga një shoqëri që e njeh dhe e jeton tolerancën fetare si vlerë.

Në këtë kuptim, Mallakastra e vitit 1943 nuk është thjesht histori. Ajo është pjesë e ADN-së morale të ushtarakut shqiptar. Është prova se misioni i Forcave të Armatosura nuk përfundon me armën, por vazhdon me mbrojtjen e njeriut. Se siguria nuk është vetëm çështje strategjie, por edhe çështje ndërgjegjeje.

Në prag të Krishtlindjes, kjo histori merr një domethënie të veçantë. Ajo na fton të reflektojmë mbi rolin tonë si shoqëri dhe si institucion. Na kujton

se forca e një ushtrie matet jo vetëm me kapacitetet e saj luftarake, por edhe me vlerat që ajo mbron dhe përçon.

Shqipëria ka zgjedhur të jetë kontribuuese e paqes. Dhe kjo zgjedhje nuk është rastësore. Ajo buron nga një histori ku, edhe në ditët më të errëta, shqiptarët zgjodhën dritën. Zgjodhën ta kthejnë humanizmin në fe dhe fenë në mision.

Sot, kur ushtarakët shqiptarë mbajnë uniformën në misione paqeruajtëse, ata mbartin edhe këtë trashëgimi. Trashëgiminë e Mallakastrës. Trashëgiminë e një kombi që e di se paqja nuk imponohet, por ndërtohet me respekt, me solidaritet dhe me përgjegjësi morale. Dhe pikërisht kjo e bën këtë histori jo vetëm një kujtim të së shkuarës, por një udhërrëfyes për të ardhmen.



Nga tryeza festive te detyra kombëtare: Roli i gruas shqiptare

Festat e fundvitit përbëjnë një nga momentet më të rëndësishme në jetën shoqërore dhe familjare të shqiptarëve. Ato nuk janë thjesht ditë pushimi apo rituale të përsëritura, por ngërthejnë vlera të thella kulturore, shpirtërore dhe njerëzore. Në thelb të këtyre festave qëndron familja, dhe në qendër të familjes gruaja shqiptare. Ajo është boshti rreth të cilit ndërtohet atmosfera festive, organizatorja e heshtur, ruajtësja e traditës dhe forca që lidh të shkuarën me të tashmen.

Gruaja shqiptare si mbartëse e traditës

Historikisht, gruaja shqiptare ka pasur një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e zakoneve dhe vlerave kombëtare. Në një shoqëri që ka kaluar periudha të vështira historike, ekonomike dhe shoqërore, ajo ka qenë shtylla që ka mbajtur gjallë identitetin familjar dhe kulturor. Festat e fundvitit janë një nga momentet ku kjo trashëgimi shfaqet më qartë. Çdo zakon, çdo ritual dhe çdo përgatitje festive bart në vetvete kujtesën kolektive të brezave.

Gruaja shqiptare është ajo që njeh kuptimin e secilit detaj: pse përgatitet një ushqim i caktuar, pse shtëpia pastrohet me një përkushtim të veçantë, pse tryeza shtrohet me kujdes dhe pse festat shihen si momente bashkimi e pajtimi. Ajo është arkitektja e një atmosfere, ku tradita dhe moderniteti bashkëjetojnë.

Përgatitjet e fundvitit: Një proces i gjatë dhe i detajuar

Festat e fundvitit nuk fillojnë në ditën e festës; ato ndërtohen me javë të tëra përgatitjesh. Gratë shqiptare janë ato që mbajnë barrën kryesore të këtij procesi. Pastrimi i shtëpisë, i cili në kulturën shqiptare simbolizon largimin e energjive negative dhe përgatitjen për një fillim të ri, është një akt simbolik po aq sa praktik. Dekorimi i ambienteve, përzgjedhja e ngjyrave, vendosja e dritave festive dhe elementëve simbolikë krijojnë një ndjenjë gëzimi dhe shprese. Gratë tregojnë kreativitet, durim dhe ndjeshmëri estetike, duke e kthyer shtëpinë në një hapësirë mikpritëse dhe të ngrohtë.

Tryeza festive: Zemra e festës

Një nga aspektet më domethënëse të festave të fundvitit është tryeza festive. Gatimet tradicionale shqiptare nuk janë thjesht ushqim; ato janë histori të gatuar me dashuri. Gratë shqiptare mbajnë mbi vete përgjegjësinë e përgatitjes së këtyre ushqimeve, shpesh duke ndjekur receta të trashëguara nga nënat dhe gjyshet. Procesi i gatimit shndërrohet në një akt dashurie dhe përkushtimi. Çdo pjatë përgatitet me kujdes, duke synuar jo vetëm shijen, por edhe simbolikën. Tryeza bëhet vendi ku mblidhen brezat, ku ndahen kujtime, ku forcohen lidhjet familjare dhe ku festohet jeta.

Roli emocional dhe shpirtëror i gruas gjatë festave

Përtej punës fizike, gruaja shqiptare luan një rol të jashtëzakonshëm emocional. Ajo është kujdestarja e harmonisë familjare, ndërmjetësja e konflikteve dhe garantuesja e një atmosfere paqësore. Gjatë festave të fundvitit, ajo përpiket që çdo anëtar i familjes të ndihet i përfshirë dhe i vlerësuar.

Në shumë raste, gruaja është ajo që mban gjallë shpresën, sidomos në familje që përballen me vështirësi ekonomike ose mungesa të ndryshme. Me forcën e saj shpirtërore, ajo e shndërron festën në një moment ku vlerat njerëzore triumfojnë mbi sfidat.

Gruaja shqiptare në shoqërinë moderne

Shoqëria shqiptare moderne ka sjellë ndryshime të mëdha në rolin e gruas. Sot, ajo është aktive

Kur uniforma bashkohet me shpirtin e festës



në tregun e punës, në arsim, në administratë, në shkencë dhe në institucione shtetërore. Megjithatë, pavarësisht angazhimeve të shumta profesionale, gjatë festave të fundvitit, gruaja shqiptare vazhdon të mbajë një rol kyç në jetën familjare.

Ky realitet tregon elasticitetin dhe fuqinë e saj për të balancuar përgjegjësitë profesionale me ato familjare. Festat e fundvitit shpesh përfaqësojnë një moment ku ajo ndalon, reflekton dhe rigjen lidhjen me rrënjët e saj kulturore.

Gratë ushtarake shqiptare: Një dimension i veçantë i sakrificës

Në këtë kontekst gjithëpërfshirës, një vëmendje e veçantë meriton rolin e grave ushtarake shqiptare. Ato përfaqësojnë një figurë të fuqishme të gruas moderne, e cila i shërben atdheut me profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim. Festat e fundvitit për gratë ushtarake shpesh kanë një kuptim ndryshe, të shoqëruar me sakrificë personale dhe emocionale.

Ndërsa shumë familje mblidhen për të festuar, gratë ushtarake mund të jenë në shërbim aktiv, larg familjes dhe fëmijëve. Megjithatë, prania e tyre është thelbësore për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit që u lejon të tjerëve të festojnë në paqe.

Balancimi i rolit profesional dhe familjar

Gratë ushtarake janë një shembull i jashtëzakonshëm i balancimit mes jetës profesionale dhe asaj personale. Ato janë njëkohësisht mbrojtëse të vendit dhe shtylla të familjes. Gjatë festave të fundvitit, kjo barrë bëhet edhe më e ndjeshme, pasi ndarja nga familja thekson rëndësinë e rolit të tyre.

Edhe në kushte shërbimi, ato përpiqen të ruajnë traditat festive, qoftë përmes gjeveve simbolike apo komunikimit me familjarët. Ky përkushtim tregon forcën e karakterit dhe ndjenjën e thellë të përgjegjësisë që i karakterizon.

Gratë ushtarake si modele frymëzimi

Figura e gruas ushtarake shqiptare shërben si model frymëzimi për brezat e rinj. Ajo dëshmon se rolet gjinore nuk janë kufizim, por mundësi për kontribut të barabartë në shoqëri. Përfshirja e grave në forcat e armatosura është një tregues i emancipimit dhe progresit shoqëror.



Festat e fundvitit janë një moment reflektimi mbi këtë kontribut, duke i dhënë vlerësimin e merituar sakrificës dhe përkushtimit të tyre.

Festat e fundvitit në Shqipëri janë një pasqyrë e qartë e rolit të pazëvendësueshëm të gruas shqiptare. Ajo është organizatore, ruajtëse e traditës, mbështetje emocionale dhe forcë morale. Qoftë në familje, në shoqëri apo në uniformë ushtarake, gruaja shqiptare përfaqëson një figurë të fortë, dinjitoze dhe thellësisht njerëzore.

Pa kontributin e saj, festat e fundvitit do të humbnin kuptimin e tyre të vërtetë. Ato do të ishin thjesht data në kalendar, pa shpirtin, ngrohtësinë dhe domethënien që vetëm gruaja shqiptare di t'u japë.

Urim nga Redaksia e Gazetës “Ushtria”

Redaksia e gazetës “Ushtria” përcjell urimet më të përzemërta dhe respektin më të thellë për të gjitha gratë dhe vajzat shqiptare, e në mënyrë të veçantë për gratë dhe vajzat në uniformë, të cilat me profesionalizëm, dinjitet dhe përkushtim i shërbejnë Forcave të Armatosura dhe atdheut.

Ju jeni shembull force, guximi dhe përgjegjësie. Në çdo detyrë që kryeni, në çdo mision që përballoni dhe në çdo sakrificë që pranoni, ju dëshmoni se shërbimi ndaj vendit nuk njeh kufij gjinorë, por vetëm vlera njerëzore, përkushtim dhe dashuri për atdheun.

Përtej uniformës, ju jeni nëna, bija, motra dhe bashkëshorte që mbani gjallë shpirtin e familjes shqiptare. Ju jeni ura që lidh disiplinën ushtarake me ndjeshmërinë njerëzore, forcën me përkujdesjen, detyrën me dashurinë.

Kontributi juaj është i çmuar jo vetëm në ruajtjen e sigurisë dhe paqes, por edhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të barabartë dhe më të fortë.

Në këto ditë festash dhe reflektimi, ju falënderojmë për shërbimin, sakrificën dhe shembullin që jepni çdo ditë. Urojmë që puna juaj të vlerësohet gjithmonë, që përpjekjet tuaja të shpërblehen dhe që rruga juaj profesionale dhe personale të shoqërohet me suksese, shëndet dhe mirëqenie.

Gëzuar festat! Mirënjoye të përhershme për gratë dhe vajzat në uniformë dhe për të gjitha gratë shqiptare, që me punën dhe përkushtimin e tyre forcojnë themelet e vendit tonë!

KOLONEL HYSNI GJERGJI
IKSHU/AFA

Deklarimet e dokumentit të mbrojtjes të 18 dhjetorit 2025, të SHBA (National Defense Authorization Act – NDAA), sjellin një ndryshim të dukshëm konceptual për Ballkanin, i cili nuk shihet më vetëm si rajon për t'u stabilizuar, por si hapësirë konkurrence strategjike. Dokumentet e mëparshme amerikane të sigurisë gjatë dy dekadave të fundit e kanë trajtuar Ballkanin Perëndimor si hapësirë post-konflikti, ku prioritet ishte ruajtja e paqes dhe menaxhimi i tensioneve etnike. Ballkani ka qenë në periferi të interesave madhore strategjike, me theks të veçantë të roli i NATO-s, si garant stabiliteti dhe të dialogu politik si instrument kryesor sigurie. Kosova përmendej kryesisht si çështje e pazgjidhur politike, nën ombrellën e KFOR-it dhe diplomacisë ndërkombëtare.

Në dokumentin NDAA-2026, stabiliteti i Kosovës dhe i Ballkanit Perëndimor trajtohet si faktor që ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e krahut juglindor të NATO-s, në besueshmërinë e angazhimit amerikan në Evropë dhe në kufizimin e ndikimit rus. Ky ndryshim konceptual e integron rajonin në arkitekturën e përgjithshme të mbrojtjes kolektive, jo më si rast i veçantë, por si pjesë e planifikimit strategjik.

Në dokumentet e mëhershme, Kosova shihej kryesisht si përfitues sigurie, e varur nga prania ndërkombëtare. Në qasjen e vitit 2025, ajo trajtohet si partner i orientuar drejt NATO-s, faktor stabiliteti në terren, dhe pjesë e aleancës rajonale ndaj ndikimeve të jashtme. Dokumenti i dhjetorit 2025 e integron Kosovën si nje strategjike, ku ndërthuren interesat euroatlantike dhe përpjekjet ruse për ndikim politik, informativ dhe të sigurisë. Dokumenti i 18 dhjetorit 2025 e pozicionon mos ndryshimin e kufijve dhe integritetin territorial si element të pa negociueshëm të stabilitetit rajonal.

Ballkani i vitit 2026 gjendet në një hapësirë tensioni të vazhdueshëm, ku frika dhe joshja bashkëjetojnë si dy forca paralele në marrëdhënien me Rusinë. Në një rajon historikisht të ndjeshëm ndaj ndikimeve të jashtme, Moska vazhdon të mbetet një aktor i pranishëm jo përmes pranisë fizike, por përmes narrativave, lidhjeve energjetike, afërsive kulturore dhe kalkulimeve gjeopolitike afatgjata. Frika buron nga perceptimi i destabilizimit. Përvoja e konfliktit në Ukrainë ka thelluar dyshimin se ndikimi rus nuk është thjesht diplomatik, por instrument strategjik që shfrytëzon dobësitë institucionale, ndarjet etnike dhe polarizimin politik në Ballkan. Për disa shtete, Rusia shihet si faktor që sfidon orientimin euroatlantik dhe ngadalëson proceset e integritetit evropian, duke ruajtur rajonin në një gjendje paqartësie të përhershme.

Megjithatë, paralelisht me frikën ekziston edhe joshja. Rusia ofron një narrativë alternative ndaj Perëndimit: sovranitet pa kushte, mbështetje politike

Ballkani midis “NDAA-2026” dhe operacioneve hibride ruse



pa reforma të dhimbshme dhe energji si mjet ndikimi ekonomik. Kjo qasje gjen terren në shoqëri ku zhgënjimi ndaj BE-së është rritur për shkak të zgjerimit të vonuar dhe premtimeve të parealizuar. Për disa aktorë politikë ballkanikë, Moska përfaqëson jo domosdoshmërisht një aleat strategjik, por një levë negociuese në raport me Brukselin dhe Uashingtonin.

Në vitin 2026, Ballkani nuk është as plotësisht nën orbitën ruse, as imun ndaj saj. Rajoni funksionon më tepër si hapësirë ndërmjetëse, ku ndikimi i Rusisë matet jo me kontroll territorial, por me aftësinë për të formësuar diskurse, për të ndikuar në vendimmarrje dhe për të mbajtur gjallë alternativën e Lindjes. Kjo e bën pranimin ruse të vështirë për t'u identifikuar dhe akoma më të vështirë për t'u neutralizuar. Në fund, dilema ballkanike nuk është zgjedhja midis Rusisë dhe Perëndimit, por mungesa e një pozicioni të qartë dhe të qëndrueshëm rajonal. Frika nga ndikimi rus dhe joshja që ai ofron janë dy anë të së njëjtës pasiguri strategjike. Derisa Ballkani të konsolidojë institucionet e tij dhe të shohë perspektivë të besueshme evropiane, Rusia do të mbetet një prani e ftohtë, por e vazhdueshme, në sfondin politik të rajonit.

Ballkani, edhe një herë tjetër, vallëzoi në ritmin e një kënge të rrezikshme, një këngë e cila ngrohu duart e nacionalizmit, por e ftohu shpresën për paqe. Ngjarja

e fundit e organizuar nga Partia Përparimtare Serbe dhe Lëvizja Socialiste më 26 tetor 2025, nuk ishte një aktivitet partiak i zakonshëm, por një demonstrim simbolik. Këngët nacionaliste, referencat ndaj “botës serbe” dhe mesazhet që mohojnë pavarësinë e Kosovës, përbëjnë një akt me domethënie strategjike, që shkon përtej kufijve të Serbisë.

Retorika e “botës serbe” krijon perceptimin e një projekti gjeopolitik që po sfidon rendin aktual rajonal. Në aspektin ideologjik, koncepti i “botës serbe” përkon me doktrinën ruse të “Russkiy mir”, e cila justifikon ndikimin kulturor e politik të Rusisë në hapësirat ku jetojnë popuj sllavë apo ortodoksë. Për Rusinë, Serbia vazhdon të mbetet pikë mbështetjeje politike dhe informative në rajon. Për Beogradin, afrimi me Moskën shërben si një mjet presioni diplomatik ndaj Bashkimit Evropian dhe SHBA-së. Kjo marrëdhënie e ndërsjellë e interesave krijon hapësirë për veprime hibride, propagandë mediatike dhe ndikim të drejtpërdrejtë në opinionin publik serb.

Rusia po e rindërton strategjinë e saj të ndikimit jo më përmes forcës ushtarake, përmes një koalicioni të heshtur midis pushtetit politik (fronit), institucionit fetar (altarit) dhe emocionit kolektiv të kombit (nacionalizmit). Ky trekëndësh simbolik ka prodhuar një formë të re të “fuqisë së butë” serbe, një ndërthurje



politike, shpirtërore dhe propagandistike, e cila synon të ruajë ndikimin serb në rajon dhe ta mbajë Ballkanin në një gjendje të tensionuar e të pasigurt. Në qendër të këtij trekëndëshi qëndron “froni”, pra pushteti personal i Aleksandar Vuçiçit. Ai ka arritur të ndërtojë një sistem të ngjashëm me “demokracitë e kontrolluara”, ku zgjedhjet ekzistojnë, por rezultati politik është i paracaktuar përmes kontrollit të mediave, administratës dhe drejtësisë. “Froni” përfaqëson instrumentin e realpolitikës, i cili e përdor nacionalizmin për të forcuar pushtetin dhe për të legjitimuar politikën e jashtme të dyfishtë.

Nga njëra anë Serbia flet gjuhën e Brukselit, por nga ana tjetër mendon me kokën e Moskës. Me këtë qasje, Vuçiç dëshiron të shfaqet si “stabilizuesi” i rajonit para Perëndimit, ndërsa në thelb kultivon retorikën e viktimës historike që mbrohet nga “bota serbe”. Kisha Ortodokse Serbe (jo vetëm e legjitimon politikisht vizionin e Vuçiçit, por e ushqen atë me mitologjinë e “misionit të shenjtë serb” një narrativë që lidh tokën, fenë dhe kombin në një “fat të përbashkët”. Në këtë trekëndësh, nacionalizmi aktivizohet përmes këngëve, simboleve, historive të betejave të humbura dhe figurave të krijuara, glorifikuara dhe të mitizuara. Në fakt, nacionalizmi serb i shekullit XXI është më i përpunuar profesionalisht, i ambalazhuar me “kulturë dhe traditë”, por që në thelb mbart elemente të qarta ekspansionizmi kulturor.

Duke përdorur ndjeshmërinë fetare si një formë e diplomacisë publike, feja pozicionohet si një forcë për të kundërshtuar armiqtë e perceptuar ideologjikë, apo për të krijuar rrjete ndërkombëtare populiste fetare për të mbështetur regjimet në fuqi. Rusia e ka shfrytëzuar krishterimin ortodoks për të forcuar ndikimin e saj gjeopolitik, veçanërisht në Evropën Lindore dhe në Ballkan.

Armatosja e përshpejtuar e Serbisë përgjatë 2022-2025, në një rajon ku pothuajse të gjithë fqinjët janë

anëtarë të NATO-s nuk është rastësi, por rezultat i një llogaritjeje strategjike shumëdimensionale. Beogradi synon të ruajë autonominë strategjike, duke mos u varur nga garancitë e sigurisë së Aleancës Atlantike dhe kërkon të projektojë imazhin e një aktori që nuk është i detyruar të përshtatet plotësisht me rendin euroatlantik. Armatosja shërben veçanërisht në raport me Kosovën dhe balancën e forcave në Ballkanin Perëndimor. Kapacitetet e reja ushtarake rrisin peshën negociuese të Serbisë dhe synojnë të krijojnë një perceptim fuqie që frenon presionin politik dhe diplomatik nga jashtë. Dimensionin e armatosjes lidhet me luftën hibride dhe ndikimin rus dhe e pozicionon Serbinë si një aktor balancues, por edhe si pikë potenciale tensioni në krahun juglindor të NATO-s.

Gjithashtu, kisha mbështet fraksionet pro ruse brenda kishave ortodokse, duke krijuar përçarje midis atyre që janë të lidhura me Moskën dhe atyre që njohin Patriarkanën Ekumenike në Stamboll. Për vendet anëtare të NATO-s dhe prezencën e saj në Ballkan, modeli “hibrid i ndikimit” është po aq i rrezikshëm sa një operacion hibrid ushtarak. Ai nuk vepron me tanke dhe raketa, por me emocione, besim dhe narrativë patriotike kombëtare. Aktivitete të tilla nuk janë të izoluara, por kanë një tendencë në rritje të militarizimit të politikës serbe, ku ushtria, kultura e luftës dhe mitet historike përdoren si instrumente frymëzuese, rekrutuese dhe mobilizuese. Këto mesazhe vështirësojnë bashkëpunimin rajonal në kuadër të NATO-s dhe PëP, duke e rritur rrezikun e polarizimit mes vendeve me orientim euroatlantik dhe atyre me lidhje tradicionale me Rusinë. Serbia përballë një zgjedhjeje strategjike që shtrihet (National Defense Authorization Act – NDAA i dhjetorit 2025), nuk mund të shmanget pafundësisht. Pyetja shtrohet: a do të mbetet ajo në kursin e neutralitetit formal, por me varësi politike nga Moska, apo do të afrohet realisht me strukturat euroatlantike? Narrativat nacionaliste dhe retorika anti-

Kosovë e shtyjnë Beogradin në drejtimin e parë dhe e largojnë perspektivën evropiane, duke e pozicionuar Serbinë si një aktor të paqëndrueshëm në sistemin e sigurisë rajonale.

Për paqen në Ballkan, nacionalizmi nuk është vetëm “retorikë e brendshme”, por edhe një instrument gjeopolitik. Në diskursin e brendshëm serb, “bota serbe” paraqitet si mbrojtje e identitetit kombëtar, por në praktikë, ajo shërben si justifikim për të vënë në lëvizje elementë radikalë që ushqejnë tensionet ndëretnike. Në një kohë kur Rusia përpiqet të ruajë ndikimin e saj përmes propagandës, energjisë dhe operacioneve informative, çdo gjest pro-rus i Serbisë kthehet në fitore simbolike për Kremlinin dhe në humbje për stabilitetin rajonal.

Manifestimet politike në Serbi dhe Bosnjë, nxisin frikën e ndarjes së re të entiteteve, ndërsa në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, ushqejnë tensione etnike e fetare. Në një plan më të gjerë, ato vështirësojnë bashkëpunimin e vendeve të rajonit me NATO-n dhe strukturat euroatlantike, duke e vendosur Ballkanin në frontin një lufte të re të ftohtë, ku Rusia kërkon ndikim, ndërsa Perëndimi përpiqet të ruajë kohezionin.

Serbia për 2026 dhe zhvillimeve SHBA-Rusi, gjendet përballë një dileme strategjike, të mbajë neutralitetin formal me prani ruse në thelb, apo të zgjedhë përfundimisht kursin euroatlantik. Unë besoj se ajo po pret, po punon dhe po lutet fort për një ndryshim të rendit botëror të kërkuar nga Rusia. Për ne fqinjët dhe për strukturat e sigurisë evropiane përfshirë NATO-n, mesazhi është i qartë, stabiliteti i Ballkanit nuk mund të merret i mirëqenë, pasi çdo “këngë e rrezikshme” mund të kthehet shpejt në sfidë reale për paqen. Në një rajon që ende mban plagët e së kaluarës, tingujt e nacionalizmit janë gjithmonë më të zhurmshëm se zërat e diplomacisë. Kjo që po ndodh është një luftë kulturore dhe psikologjike për ndikim, e cila nëse nuk njihet dhe përballohet me inteligjencë strategjike, mund të prodhojë destabilizim afatgjatë.



Shqipëria pas Luftës së Parë Botërore

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria ndodhej në një situatë tejet të ndërlikuar politike dhe ushtarake. Territori i saj ishte i pushtuar nga ushtri të huaja, ndërsa fuqitë fqinje dhe interesat e Fuqive të Mëdha kërcënonin seriozisht ekzistencën e shtetit shqiptar. Në këtë realitet, elita politike shqiptare u përpoq të organizonte një qëndrim të përbashkët kombëtar për mbrojtjen e pavarësisë dhe tërësisë territoriale.

Thirrja dhe zhvillimi i Kongresit

Më 25 dhjetor 1918, në qytetin e Durrësit, u hap Kongresi Kombëtar, i cili zhvilloi punimet deri më 27 dhjetor. Në kongres morën pjesë 53 delegatë nga pjesa më e madhe e territorit shqiptar nën pushtimin italian. Për arsye politike dhe ushtarake, munguan përfaqësues nga Vlora, zonat nën pushtimin serb (Peshkopia, Luma) dhe ato nën administrimin francez, si Korça.

Megjithatë, prania e figurave të rëndësishme politike dhe diskutimet e zhvilluara i dhanë kongresit një peshë të veçantë në jetën politike të vendit.

Vendimet kryesore dhe organizimi shtetëror

Kongresi i Durrësit vendosi formimin e një qeverie të përkohshme me 14 anëtarë, me kryeministër Turhan Pashë Përmetin. Gjithashtu, u krijua një Pleqësi (senat) si organ këshillues, duke synuar ndërtimin e një strukture shtetërore funksionale në kushtet e pasigurta të kohës.

Një nga vendimet më të rëndësishme ishte caktimi i delegacionit shqiptar që do të përfaqësonte Shqipërinë në Konferencën e Paqes në Paris, ku do të vendosej fati i shumë shteteve pas luftës.

Kongresi i Durrësit (1918): Përpyjekje politike për mbijetesën e shtetit shqiptar

Programi politik dhe dimensionet strategjike

Programi politik i miratuar nga Kongresi kishte një karakter kombëtar dhe strategjik. Ai parashikonte:

- ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë;
- mbrojtjen e tërësisë territoriale;
- rishikimin e kufijve të vitit 1913 në favor të kufijve etnikë shqiptarë;
- ruajtjen e qetësisë së brendshme dhe stabilitetit shtetëror.

Delegatët shprehën besimin ndaj Fuqive fituese të luftës, veçanërisht ndaj presidentit amerikan Uillson dhe parimit të vetëvendosjes së popujve, duke shpresuar se këto parime do të garantonin të drejtat kombëtare shqiptare.

Ndikimi i Italisë dhe kompromisi politik

Në prapaskenë të Kongresit qëndronte ndikimi i politikës italiane. Qeveria italiane, e pranishme ushtarakisht në Shqipëri, nuk mbështeste krijimin e një qeverie shqiptare plotësisht të pavarur, por favorizonte formimin e një këshilli ose komiteti kombëtar me rol të kufizuar politik.

Megjithatë, për realizimin e këtij projekti ishte i domosdoshëm një kongres kombëtar, çka e bëri të

pashmangshëm kompromisin mes palës shqiptare dhe interesave italiane.

Qëndrimi i “Vatrës” dhe polemikat historike

Federata Panshqiptare “Vatra” mbështeti procesin e formimit të qeverisë së Durrësit, duke e konsideruar atë si një mjet të domosdoshëm për të përfaqësuar Shqipërinë në Konferencën e Paqes. Ky qëndrim ka qenë objekt kritikash nga historiografia shqiptare e mëvonshme, e cila e ka vlerësuar këtë mbështetje si kompromis të tepërt me Italinë. Megjithatë, në kushtet e prishjes së ekuilibrave politikë në Ballkan, të shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze dhe të rrezikut real të copëtimit të Shqipërisë, ky kompromis shihet nga disa studiues si një zgjedhje taktike e diktuar nga rrethanat.

Vlerësim historik-ushtarak

Kongresi i Durrësit përfaqëson një përpyjekje të rëndësishme politike dhe strategjike për ruajtjen e shtetit shqiptar në një moment kritik. Edhe pse i kufizuar në përfaqësim dhe i kushtëzuar nga prania e forcave të huaja, ai shërbeu si një hap i domosdoshëm drejt konsolidimit të institucioneve dhe mbrojtjes së interesave kombëtare në arenën ndërkombëtare.

Allag-E: Interceptor i ri që gjuan dronët si shqiponjë dhe ndryshon rregullat e lojës në qiell

Një epokë e re ku dronët po sfidojnë sigurinë globale dhe kërkojnë mbrojtës të specializuar

Në dekadat e fundit, dronët kanë kaluar nga pajisje të vogla për filmime në mjete të sofistikuara ushtarake dhe civile. Ata përdoren për spiunazh, transport të ngarkesave të rrezikshme, dhe madje edhe për sulme të drejtpërdrejta ndaj infrastrukturës kritike. Ky zhvillim ka krijuar një boshllëk të madh në sigurinë ajrore, sepse sistemet tradicionale të mbrojtjes nuk janë gjithmonë të përshtatshme për të neutralizuar kërcënime kaq të vogla dhe të lëvizshme. Pikërisht këtu hyn në lojë Allag-E, interceptori i ri që është projektuar për të kapur dhe shkatërruar dronë që fluturojnë me shpejtësi deri në 124 milje në orë, duke hapur një kapitull të ri në mbrojtjen ajrore.

Shpejtësia, manovrimi dhe teknologjia e sofistikuar që e bëjnë Allag-E një "shqiponjë mekanike"

Allag-E nuk është thjesht një avion interceptues. Ai është një kombinim i teknologjisë më të fundit me dizajn aerodinamik që i lejon të kryejë manovra të shpejta dhe të sakta.

- Motorët e fuqishëm i japin aftësinë të arrijë shpejtësi të larta dhe të ndjekë dronët në çdo lëvizje.
- Sensorët e avancuar përfshijnë radarë të ndjeshëm dhe kamera termike që identifikojnë objektiva të vegjël edhe në kushte të vështira atmosferike.
- Armët e integruara variojnë nga raketat ajër-ajër të vogla, deri te sistemet lazer dhe pajisjet elektronike që mund të ndërpresin komunikimin e dronëve.
- Autonomia e dyfishtë: Allag-E mund të funksionojë si i pilotuar, por edhe në mënyrë autonome, duke e bërë fleksibil për misione të ndryshme.

Ky kombinim e shndërron në një "shqiponjë mekanike" që sundon qiellin, duke u zhytur mbi objektivat me saktësi kirurgjikale.

Pse interceptimi i dronëve është një domosdoshmëri për sigurinë kombëtare dhe civile

Dronët nuk janë më thjesht pajisje për argëtim apo filmime. Ata përfaqësojnë një rrezik real:

- Sulme ndaj infrastrukturës kritike: Aeroportet, bazat ushtarake dhe qendrat energjetike janë objektiva të lehta për dronët.
 - Spiunazh: Dronët mund të mbledhin informacione të ndjeshme pa u vënë re.
 - Transport i eksplozivëve: Në konfliktet moderne, dronët përdoren për të dërguar ngarkesa të rrezikshme drejt objektivave.
- Në këtë kontekst, Allag-E është një mbrojtës i domosdoshëm, duke neutralizuar kërcënimet përpara se ato të materializohen dhe duke garantuar sigurinë e qytetarëve.

Krahasimi me shqiponjën: Një metaforë që shpjegon forcën, vigjilencën dhe frikën që ngjall

Shqiponja është simbol i fuqisë dhe dominimit në qiell. Ashtu si ajo që zhytet me shpejtësi për të kapur pre, Allag-E është projektuar të zbresë mbi dronët me saktësi kirurgjikale. Ky krahasim nuk është vetëm figurativ, por edhe teknik: shpejtësia, instinkti i sensorëve dhe precizioni i armëve e bëjnë këtë interceptor një "shqiponjë mekanike" që sundon hapësirën ajrore. Për kundërshtarët, ky imazh është frikësues, sepse tregon se dronët nuk janë më të paprekshëm.

Shembuj realë të përdorimit të interceptuesve kundër dronëve në konflikte moderne

- Në konfliktet e viteve të fundit, dronët kanë luajtur një rol të madh:
- Ukraina dhe Rusia kanë përdorur dronë për sulme të shpejta dhe spiunazh.
 - Lindja e Mesme ka parë përdorimin e dronëve për sulme ndaj rafinerive të naftës dhe bazave ushtarake.
 - Konfliktet urbane shpesh përfshijnë dronë të vegjël që përdoren për survejim dhe koordinim të sulmeve.
- Në këto situata, interceptues si Allag-E do të ishin vendimtarë për të neutralizuar kërcënimet në kohë reale dhe për të ruajtur balancën e fuqisë.

Sfida të mëdha përpara: Kostoja, evolucioni i dronëve dhe dilemat etike të përdorimit autonom

- Megjithatë Allag-E duket si një zgjidhje revolucionare, ka disa pengesa që duhen kapërcyer:
- Kostoja e lartë e prodhimit dhe mirëmbajtjes, që mund ta bëjë të vështirë për shumë vende ta adoptojnë.
 - Adaptimi ndaj dronëve më të shpejtë dhe më inteligjentë, të cilët pritet të shfaqen në të ardhmen.
 - Debatet etike mbi përdorimin e interceptuesve autonomë pa ndërhyrje njerëzore, që ngre pyetje mbi kontrollin dhe përgjegjësinë.
- Këto sfida tregojnë se teknologjia duhet të ecë paralelisht me politika të qarta dhe të përgjegjshme.

Allag-E si simbol i epokës së re të luftës ajrore, ku dronët dhe interceptuesit përcaktojnë balancën e fuqisë

Allag-E nuk është thjesht një avion interceptues. Ai është një simbol i epokës së re të luftës ajrore, ku dronët dhe mjetet që i neutralizojnë ata do të përcaktojnë balancën e fuqisë. Si shqiponja që sundon qiellin, ky interceptor premtë për të mbrojtur hapësirën ajrore me shpejtësi, inteligjencë dhe efikasitet, duke hapur një kapitull të ri në historinë e mbrojtjes.



Disiplina e luftës, kufizimet për ushtarët

Rëndësia e disiplinës në kohë lufte: pse kufizimet janë jetike

Disiplina e luftës është një shtyllë themelore e ligjit ndërkombëtar. Ajo synon të mbrojë civilët, të kufizojë vuajtjet e panevojshme dhe të ruajë dinjitetin njerëzor. Pa këto rregulla, lufta shndërrohet në një akt shkatërrimi total, ku nuk ka dallim mes ushtarit dhe civilit. Konventat e Gjenevës janë dokumentet kryesore që përcaktojnë këto kufizime, duke i bërë ato të detyrueshme për çdo ushtri.

Nëse një ushtri nuk respekton këto norma, ajo humbet jo vetëm legjitimitetin ndërkombëtar, por edhe besimin e popullsisë që e rrethon. Historia ka treguar se ushtritë që kanë shkelur ligjet e luftës janë përballur me izolim diplomatik, sanksione dhe gjykime për krime lufte. Ushtarëve u ndalohet të kryejnë një sërë veprimesh gjatë luftës, të cilat përbëjnë krime lufte nëse shkelën.



Kufizimet kryesore për ushtarët gjatë konflikteve të armatosura

Plaçkitja për përfitim personal nuk lejohet

Plaçkitja gjatë kohës së luftës nuk është asgjë e re, por nuk jemi më në kohën e Vikingëve. Rregulli 52 i Ligjit Ndërkombëtar Humanitar (DNH) është i qartë: plaçkitja është e ndaluar.

Megjithatë, ekziston një paralajmërim. Ndërsa marrja e një suvenir në shtëpi është e ndaluar, nëse furnizimet merren për shkak të nevojës ushtarake, kjo nuk përbën përfitim personal. Rregulli 49 i DNH-së thotë se “palët në konflikt mund të sekuestrojnë pajisje ushtarake që i përkasin një pale kundërshtare si plaçkë lufte”.



Asnjë sulm i papritur pas armëpushimit, asnjë sulm i papritur në zonat civile

Rregulli 64 i DNH-së thotë se “ndalohet lidhja e një marrëveshjeje për të pezulluar luftimet me qëllim sulmin në befasi të armikut duke u mbështetur në atë marrëveshje”.

Përveç kësaj, duhet të ketë paralajmërim paraprak për sulmet që mund të ndikojnë te civilët. Rregulli 20 thotë se “çdo palë në konflikt duhet të japë paralajmërim efektiv paraprak për sulmet që mund të ndikojnë te popullsia civile, përveç nëse rrethanat nuk e lejojnë”.



Vetëm objektivat ushtarake mund të sulmohen

Trupat duhet të sulmojnë vetëm objektivat ushtarake. Sipas Rregullit 16 të DNH-së, trupat “duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur për të verifikuar që objektivat janë objektiva ushtarake”.



Largimi i civilëve është një përparësi

Ushtarët duhet të sigurohen që civilët janë të sigurt para se të nisin një sulm. “Çdo palë në konflikt duhet, në masën e mundshme, të largojë personat civilë dhe objektet nën kontrollin e saj nga afërsia e objektivave ushtarake”, thuhet në rregullin 24 të DNH-së.



Asnjë sulm ndaj spitaleve, zonave të sigurisë ose zonave të neutralizuara

Rregulli 35 i DNH-së është shumë i qartë kur bëhet fjalë për sulmin ndaj vendeve të tilla si spitalet. Ai thotë: “Drejtimi i një sulmi kundër një zone të krijuar për të strehuar të plagosurit, të sëmurët dhe civilët nga efektet e armiqësive është i ndaluar”.



Asnjë sulm kundër personelit mjekësor dhe fetar

Rregulli 30 i DNH-së është gjithashtu i qartë kur thotë se “sulmet e drejtuara kundër personelit mjekësor dhe fetar dhe objekteve që shfaqin emblemat dalluese të Konventave të Gjenevës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare janë të ndaluara”.



Gazetarët duhet të mbahen të sigurt...

...përveç nëse janë të përfshirë në mënyrë aktive në luftë. Rregulli 34 thotë se “gazetarët civilë të angazhuar në misione profesionale në zonat e konfliktit të armatosur duhet të respektohen dhe të mbrohen për sa kohë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në armiqësi”.



Toka bujqësore nuk mund të shkatërrohet

Shkatërrimi i tokës bujqësore të armikut është në fakt një krim lufte. Shkatërrimi i të korrave, bagëtive, furnizimeve me ujë dhe çdo gjëje tjetër që mund të ndikojë në mbijetesën e civilëve është i ndaluar gjatë kohës së luftës.

Rregulli 54 i DNH-së është i qartë në lidhje me këtë: “Sulmi, shkatërrimi, heqja ose kthimi i objekteve të padobishme të domosdoshme për mbijetesën e popullsisë civile është i ndaluar”.



Ushtarët duhet të respektojnë mjedisin natyror

Sipas rregullit 45 të DNH-së, metodat ose mjetet e luftës që “shkaktojnë dëme të përhapura, afatgjata dhe të rënda në mjedisin natyror janë të ndaluara”. Rregulli gjithashtu thotë se “shkatërrimi i mjedisit natyror nuk mund të përdoret si armë”.



Vdekja nga uria si metodë lufte nuk lejohet

Mbijetesa e popullsisë civile është me të vërtetë e rëndësishme dhe nuk lejohet që njerëzit të vdesin nga uria. Përveç rregullit 54 të lartpërmendur, ekziston edhe rregulli 53, i cili thotë se “përdorimi i urisë si armë është i ndaluar”.



Simbolet e rrjeteve humanitare nuk mund të përdoren në asnjë rast

Veshja e helmetave blu për të fituar një avantazh dhe për të mashtruar armikun duke pretenduar se vepron me mirëbesim konsiderohet pabesi. E njëjta gjë vlen edhe për vendosjen e simboleve të Kryqit të Kuq ose Gjysmëhënës së Kuqe në automjetet ushtarake. Rregulli 65 i DNH-së thotë se “vrasja, plagosja ose kapja e një kundërshtari duke përdorur pabesi është e ndaluar”. Paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara (OKB) janë të famshëm për veshjen e helmetave blu. Ushtarëve nuk u lejohet të pozojnë si Paqeruajtës të OKB-së. Ky është në fakt një krim lufte i njohur si pabesi.



Asnjë përdorim i papërshtatshëm i flamurit të bardhë

Rregulli 58 i DNH-së është se “përdorimi i papërshtatshëm i flamurit të bardhë të armëpushimit është i ndaluar”. Sipas Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, kjo konsiderohet krim lufte “në konfliktet e armatosura ndërkombëtare kur rezulton në vdekje ose lëndime të rënda personale”.



Asnjë minë tokësore kundër personelit

Ushtarët duhet të bëjnë dallime midis trupave armike dhe civilëve, dhe çdo armë e përdorur që nuk bën dallim midis të dyjave nuk mund të përdoret. Rregulli 71 i DNH-së thotë se “përdorimi i armëve që janë nga natyra e tyre pa dallim është i ndaluar”.



Armët pa dallim objektiv nuk mund të përdoren

Shembuj të tjerë të armëve që janë nga natyra pa dallim përfshijnë “armë kimike, biologjike dhe bërthamore; mina, helm, eksplozivë të shkarkuar nga balonat, raketa V-1 dhe V-2, bomba thërrmuese, raketa Scud, raketa Katyusha, armë nderëse dhe teknika të modifikimit mjedisor”.



Ushtarët nuk mund të shkaktojnë lëndime të tepërta ose vuajtje të panevojshme

Rregulli 70 i DNH-së thotë se “ndalohet përdorimi i mjeteve dhe metodave të luftës që janë të natyrës për të shkaktuar lëndime të tepërta ose vuajtje të panevojshme”.

Shembujt përfshijnë “shtiza ose shtiza me kokë me gjemba, bajoneta me tehe të dhëmbëzuara, plumba që zgjerohen dhe shpërthejnë, armë që lëndojnë kryesisht nga fragmente që nuk dallohen nga rrezet X, duke përfshirë predha të mbushura me xham të thyer, armë ndezëse dhe armë verbuese me lazer”, për të përmendur disa.

Pasojat e shkëljes së disiplinës: nga tragjedia humanitare tek gjykatat ndërkombëtare

Kur këto kufizime shkelen, pasojat janë të shumëfishta:
Humanitare: Civilët humbin jetën, komunitetet shkatërrohen
dhe trauma mbetet për breza.

Ligjore: Ushtarët dhe komandantët mund të përballen me gjykata ndërkombëtare për krime lufte.

Strategjike: Shkeljet minojnë legjitimitetin e një ushtrie dhe e kthejnë konfliktin në një burim izolimi ndërkombëtar.

Gjykata Ndërkombëtare Penale ka hapur hetime për krimet e kryera në Ukrainë, duke treguar se askush nuk është mbi ligjin.

Disiplina si mburojë e humanitetit

Shembulli i shkeljeve të dokumentuara nga Rusia në Ukrainë është një paralajmërim i qartë se “pa disiplinë, lufta shndërrohet në barbarizëm”. Kufizimet për ushtarët nuk janë thjesht rregulla, por garanci për të ruajtur një minimum humaniteti në mes të dhunës. Respektimi i tyre është detyrë morale, ligjore dhe strategjike për çdo ushtri që pretendon të veprojë në përputhje me normat ndërkombëtare.



Buzëqeshjet e së Nesërme:

FESTË DHE GËZIM PËR FËMIJËT E FORCAVE TË ARMATOSURA

